



Mbi sjelljen etike të mësuesit në punë

MSc. Valentina Fakaj, MSc. Suela Ramaj

Abstract

The teacher is at the service of society, so his sacred work requires dedication and cooperation to carry out his educational activity with his students. As educators we must bear in mind that every student we teach is an individual, a product of culture, the environment, health, temperament, and a particular personality. The attitude and behavior of the teacher is as important as the activities he / she conducts with the students. Work ethic begins with the preparation that traditionally means with the teacher's diary, which defines the concepts it will present, the teaching methods it will use, the object it aims to achieve, which should not be slogans, for issues concrete, concepts that need to be understood and gradually adopted.

Keywords: ethics, dedication, behavior, education, code of ethics.

Abstrakt

Mësuesi është në shërbim të shoqërisë, prandaj puna e tij e shenjtë kërkon përkushtim dhe bashkëpunim për të realizuar veprimtarinë e tij edukative me nxënësit e tij. Si edukator duhet të mbajmë parasysh se çdo nxënës që ne mësojmë është një individ, produkt i kulturës, i mjedisit, i shëndetit, i temperamentit dhe i personalitetit të veçantë. Qëndrimi dhe sjellja e mësuesit është po aq e rëndësishme sa dhe aktivitetet që ai zhvillon me nxënësit.

Etika në punë fillon me përgatitjen që tradicionalisht do të thote me ditarin e mësuesit, i cili përcakton konceptet që do të paraqesë, metodat e punës mësimore që do të përdorë, objektin që synon të arrijë, të cilat nuk duhet të jenë sllogane, për çështje konkrete, koncepte që duhet të kuptohen dhe gradualisht të përvetësohen.

Fjalë kyçe: etikë, përkushtim, sjellje, edukatë, kod etike.

* * *

Hyrje

Mësuesi është në shërbim të shoqërisë, prandaj puna e tij e shenjtë kërkon përkushtim dhe bashkëpunim për

të realizuar veprimtarinë e tij edukative me nxënësit e tij. Ai është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Për të qenë i aftë në punën e tij, mësuesit nuk i mjafton të zotërojë vetëm lëndën; ai duhet të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht të nxënësi, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore.

Si edukator duhet të mbajmë parasysh se çdo nxënës që ne mësojmë është një individ, produkt i kulturës, i mjedisit, i shëndetit, i temperamentit dhe i personalitetit të veçantë. Këta faktorë asnjëherë nuk janë statikë. Me rritjen ndodhin edhe ndryshime.

Qëndrimi dhe sjellja e mësuesit është po aq e rëndësishme sa dhe aktivitetet që ai zhvillon me nxënësit. Një mësues efektiv është gjithashtu ai që di dhe kupton disa parime bazë mbi të cilat nxënësi nxë dhe gjithashtu di të përdorë trajtime të ndryshme në mësimdhënien për të ndihmuar të gjithë nxënësit.

Shkolla është institucioni mësimor dhe edukativ, që veprimtarinë kryesore të saj, orën e mësimit, e zhvillon në mënyrë të planifikuar e të organizuar. Etika në punë fillon me përgatitjen që tradicionalisht do të thote me ditarin e mësuesit, i cili përcakton konceptet që do të paraqesë, metodat e punës mësimore që do të përdorë, objektin që synon të arrijë, të cilat nuk duhet të jenë sllogane, për çështje konkrete, koncepte që duhet të kuptohen dhe gradualisht të përvetësohen

1.Sjellja etike në punë

Trajnimi i punonjësve me etikën e punës nuk është shmangje nga fronti kryesor, modernizmi shkencor pedagogjik i procesit mësimor, zbatimi rigoroz e krijues i kurrikulës shkollore etj, përkundrazi është përgatitja psiko-pedagogjike e mësuesve për t'u gjetur në punë të përgatitur, me predispozitë maksimale, me përkushtim, përgatitje serioze në aspektin shkencor të fushës, të lëndës apo lëndëve që zhvillohen.

Etika në punë fillon me përgatitjen që tradicionalisht do të thotë me ditarin e mësuesit, i cili përcakton konceptet që do të paraqesin, metodat e punës mësimore që do të përdorë, objektin që synon të arrijë, të cilat nuk duhet të jenë sllogane, për çështje konkrete, koncepte që duhet të kuptohen dhe gradualisht të përvetësohen¹.

¹ Kraja,M, *Mësuesi, Pedagogu, Personaliteti, Etika e tyre*, Tiranë, 2012, f.410



Etika e punës kërkon që në minutat e para dhe gjatë gjithë orës së mësimit mësuesi duhet të qëndrojë në këmbë, pavarësisht nga metoda që zbaton. Nuk ka metodë mësimore që mësuesi të qëndrojë i ulur e të shohë klasën, apo më keq të merret me ndonjë lexim gazete, të shifet në pasqyrë, të merret me celularin etj të cilat janë tërësisht jashtë etike.

Mësuesit nuk duhet të qëndrojnë mbi bankë apo mbi tavolinë të nxënësve apo të mësuesit. Ata duhet të kontrollojnë veten para hyrjes në mësim, se mos kanë ndonjë konçë zbrëthyer, janë të pakrehur etj.

Në asnjë mënyrë mësuesit nuk i lejohet të vijë era alkool në ambjentet e shkollës. Gjithashtu edhe pirja e duhanit në korridoret e shkollës është një shkelje e rëndë e etikës. Etika e punës merr kuptime të ndryshme në pozicione të ndryshme, por etika e punës së mësuesit përveç disa kërkesave të zakonshme për çdo profesion, ka edhe disa specifika që janë të domosdoshme, të cilat në një vend tjetër pune mund të mos kenë vlera aq të veçanta. Mësuesit kanë kërkesat profesionale të detyrueshme lidhur me tërë organizimin e procesit mësimor, të nivelit të njohurive të nxënësve, por ato kanë edhe vlera po kaq të mëdha edhe disa kërkesa profesionale, morale, në marrëdhënie me nxënësit dhe kolegët, të cilët lidhen me shërbimet që kryejnë.

Zbatimi apo vëmëndja ndaj etikës së punës ndikon në rritjen e kulturës së punës dhe të jetës. Autoritarizmi, korrupsioni dobësojnë rëndë kualitetin e punës. Programet e etikës në punë kultivojnë një frymë të fortë të punës në grup dhe të arritjes së produktit të dëshiruar. Aftësia për të punuar në grup është një faktor i harmonizimit të punës, sidomos në veprimtaritë ndërlendore dhe i ndërtimit të një fronti unik të edukimit, sidomos në shkollat parauniversitare.

Programet e etikës në institucione arsimore, ndikojnë në zvogëlimin e masave ndërshkuese në mësues e sidomos në nxënësit, ato nxiten më shumë nga e mira pozitiveja e cila u jep nxënësve kënaqësi, qetësi dhe i nxitë, i motivon drejt arritjeve më pozitive, krijon marrëdhënie më të drejta mes punonjësve, nxënësve duke krijuar një klimë pedagogjike të shëndetshme në institucionin arsimor. E gjithë puna në drejtim të etikës profesionale në punë, duhet të japë produkte konkrete: të gjenerojë sjellje të ndershme dhe të drejta në punë, të organizohet kualifikimi i brëndhëm i kuadrit, që të ndikojnë në vlera, sjellje dhe veprime të dobishme.

Në punën për shmangjen e qëndrimeve jo etike në punë, është e dobishme edhe aplikimi i qëndrimeve të buta me zëmërgjerësi, jo me qëndrime të tejskajshme liberale, se sa në futjen në botën e nxënësit, që mund të reflektojë nga komunikimi i sinqertë, i ngrohtë dhe i sjellshëm me ta, çka do të japë në disa raste më tepër se të mbahej qëndrim pedant i egër e thellësisht zyrtar.

Një shkelje e etikës nga ana e mësuesve është përgojimi i nxënësve.

Prindërit, familja, shoqëria, shteti ju kanë besuar mësuesve, krijesat më të shtrenjta bijtë dhe bijat e tyre, vetë ardhmërinë. Kjo përgjegjësi e rëndë kërkon rigorozitet në shumë aspekte të etikës profesionale për mësuesit. Gjithashtu nxënësit duhet të gëzojnë edhe dashurinë dhe respektin e mësuesve edhe pse janë

të vegjël dhe me pak përvojë jete. Prandaj, ato përveç njohurive shkencore, presin të marrin nga mësuesit e tyre edhe ndihma dhe këshilla për ato që nuk dinë.

Në goftë se mësuesi i shikon nxënësit edhe me syrin e prindit, efektiviteti i ndihmës do të jetë më i efektshëm, bashkëpunimi e marrëdhëniet midis tyre do të jenë edhe më të shëndosha. Është shumë e dëmshme kur shpërqëndrohet sinqeriteti e konfidenca e nxënësve, duke i bërë objekt thashethemesh, degradimesh midis kolegëve apo shoqërisë. Kjo dëmton shumë punën, nxënësit madje edhe vetë shoqërinë.

Eika profesionale kërkon besnikëri ndaj kolegëve, drejtuesve dhe nxënësve. Mësuesit kanë një kontratë me drejtuesit e institucioneve, me prindërit, të cilës duhet t'i përmbahen. Besnikëria e mësuesit duhet të jetë në harmoni me besnikërinë e drejtuesit të shkollës, të prindit dhe të kolegëve. Por kjo nuk e pengon debatin. Duhet një frymë bashkëpunimi demokratik i besnikërisë që të ketë një rezultat veprimi etik. Duhet punuar që në shkollë, në institucion të zhvillohen zakonet etike, madje të krijohet traditë në këtë fushë edhe për mësuesit e rinj ose të ardhur nga institucionet e tjera.

Arsimi, shkollat përfshirë të gjitha hallkat e sistemit arsimor, kanë një përqindje shumë të lartë të punonjësve të tyre të përbërë nga gra dhe vajza. Si intelektuale ato vishen konform etikës qytetare të veshjeve në institucion. Lidhur me veshjen e vajzave, sidomos të grave, kanë vëndin e tyre edhe bizhuteritë të cilat janë të ndara në natyrën e tyre:

-Në ditë të zakonshme pune

-Me solemnitate ku përfshihet edhe institucioni.

Në rastin e parë, pa hyrë në shabllone bizhuteritë e zakonshme, një unazë apo varëse e thjeshtë, ose jo, është çështje individuale. Ndyshe kur bizhuteritë janë të mëdha, si vathë shumë të mëdhenj, me ngjyra të forta, varëse të shumta të mëdha e të theksuara, të cilat tërheqin vëmëndjen e nxënësve, sidomos vajzave dhe ndikojnë tek ato. Edhe tek karakteri fetar i bizhuterive me vathë apo varëse me shënja të theksuara fetare, si kryq, yll etj të cilat i përkasin feve të caktuara dhe serviren nga mësuesit në një shkollë laike, ku respektohet çdo besim, por nuk ushtrohet, nuk propagandohet. Ndryshe është kur institucioni arsimor është i licënsuar si institucion fetar, ku kurrikula shkollore prej rreth 80% i përket kulturës së përgjithshme dhe pjesa tjetër asaj fetare. Në shkollë veshja duhet të jetë, si në një institucion, serioz, pa minifunde apo gjoks zbrëthyes si për gratë apo burrat, sepse etika e veshjes, e paraqitjes së mësuesit, është pjesë përbërëse e etikës profesionale me mënyrë më të theksuar se në mjedise të tjera. Në këtë kuadër shtrihet edhe veshja, këpucët jo me baltë, të rregullta e të llustruara normalisht, edhe krehja e rregullt e flokëve apo e mjekrës etj. Papastërtia, rregullsia, deri tek pastërtia ose jo e dhëmbëve të mësuesit bie në sy të nxënësve siç bie në sy ndonjëherë ndonjë mungesë kontrolli në komçat, shamia e xhepit etj.

Nxënësi mëson nga modeli që ka përpara. Celualri kurrësesi nuk duhet të jetë i hapur gjatë orës së mësimit. Paraqitja e mësuesit burrë ose grua, duhet të jetë pjesë e rëndësishme e etikës profesionale.

Nënvlerësimi i këtyre qëndrimeve se "të vegjël" janë



nxënësit, është nënvlerësimi i një aspekti të rëndësishëm të punës në shkollë, dhe kanë të bëjnë me probleme serioze të etikës profesionale.

2. Mësuesi, standartet lëndore të punës mësimore- edukative ndërthuren me etikën profesionale

Standartet janë të lidhura me objektivat që ka mësuesi për lëndën e tij, për nxënësit e klasës, për fushën e edukimit, të sjelljes së nxënësve, të marrëdhënieve të tyre njëri me tjetrin, me shkallët e përcaktimit të niveleve të caktuara të njohurive në fusha të veçanta të kurrikulës shkollore, të formimit të tyre si qytetarë dhe punonjës të nesërm. Komunikimi, si kërkesë themelore e etikës së tij profesionale, me nxënësit e tij në rradhë të parë, është domosdoshmëri në aktivizimin masiv të nxënësve. Për të arritur standartet mësuesit i duhen disa aftësi, ai duhet të jetë kompetent në planifikimin e lëndës, të orëve të mësimit, në mirëorganizimin e zhvillimit të tyre, në punë të përbashkëta me nxënësit². Ora e mësimit me në qendër nxënësin është një proces komunikimi i pandërprerë, që kërkon mjeshtëri profesionale, takt, intuitë në punën me nxënësit për t'i drejtuar drejt koncepteve themelore në mënyrë logjike, si kërkesa të standarteve lëndore në fusha të caktuara. Mësuesi duhet të komunikojë me të gjithë nxënësit si grup dhe individualisht, ti nxisë e motivojë, të nxjerrë përfundime me to, të realizojë aspektet edukative të lëndës. Standartet për mësuesin janë disa parakushte të domosdoshme për të realizuar standartet e përmbajtjeve lëndore, apo si klasë të nxënësve në cilin e ulët të arsimit bazë, të cilat janë të lidhura e të ndërvarur njëri standart profesional me standartin e përmbajtjes së këtij "caku" njohurish, ku duhet të arrijë nxënësi në nivel maksimal, mesatar apo minimal, çka është e lidhur ngushtë me realizimin e synimeve cilësore të punës mësimore edukative.

Të gjithë mësuesit duhet të njohin në mënyrë të detajuar standartet lëndore që do të arrijnë bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë, nxënësit në fushën e tyre, çka është e lidhur me aftësitë, përgatitjen e mësuesit, organizimin e punës nga ana e tij dhe sigurimin e produktit, realizimin e standardit lëndor apo si klasë.

Pikërisht, për këtë arsye një mësues i mirë duhet të zbatojë parimet themelore didaktike. Standardet e përgatitjes së mësuesve të rinj janë të lidhura me fusha të caktuara të kurrikulës universitare, të nivelit të parë apo të dytë, si dhe me praktikën e tyre si një rrugë në formimin e tyre etik.

Në universitetin e Harvardit ka një betim të lexueit në bibliotekë, se nuk do ta grisë, dëmtojë, ta vjedhë librin.

Ka edhe urdhra, të kohëve të ndryshme nga autorë të ndryshëm për mësuesin. Dhjetë urdhrat e mësuesit nga George Polvja janë:

- Ki interes për lëndën tënde
- Njihe lëndën tënde
- Njih mënyrat sipas të cilave mësohet, mënyra më e mirë për të mësuar çdo gjë është ta zbulosh vetë.
- Kërko të lexosh në fytyrën e nxënësve, të kuptosh nevojat dhe vështirësitë e tyre, mundohu të vihesh në vendin tyre.

- Jepu atyre jo vetëm informacione, por edhe mënyrën se si të dish të punosh, shprehi të të menduarit dhe shprehi të punës metodike.
- Mësoji se si të zbulojnë.
- Mësoji se si të dinë të demostrojnë.
- Kërko ato anë të problemit në fjalë, që mund të jenë të vlefshme për të zgjidhur problemet e tjera, kërko që të evidentosh skemën e përgjithshme që fshihet në situatën konkrete të problemit.
- Mos e trego asnjëherë sekretin, lëre që ta zbulojnë ata para se ta thuash ti, zbuloje vetëm kur ata vetë nuk munden.
- Sygjeroja por mos i detyro.

Unesco në vlerësim të figurës së mësuesit, ka caktuar 5 tetorin ditën e mësuesit nëpërmjet R.Dottres u formulua edhe për profesionin e mësuesit një model betimi solemn siç bëjnë mjekët me betimin e Hipokratit. Betimi shpreh sensin e deduktimit dhe profesionalizmit që mësuesit ndiejnë. Studentë, prindër, kuadri pedagogjik, nxënësit etj. e ndiejnë betimin si një shtysë lëvizëse e të kuptimshme në ceremoninë e diplomimit³. Nëpërmjet këtij betimi unë afirmojë dedikimin tim ndaj profesionit të arsimit. Me këtë pohim, unë përfshij detyrimet e edukatorëve profesionistë për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme, për të ngritur kuptimin dhe kompetencën njëzëre dhe për t'i sjellë nder orvajtjeve të mësimdhënies dhe mësimit. Unë vetë i pranoj këto detyrime dhe do të jem vigjilent dhe i përgjegjshëm që edhe kolegët e mi t'i pranojnë e mbështesin ato. Unë do të jem i vëmendshëm ndaj përgjegjësisë për të rritur inteligjencën e nxënësve nëpërmjet një vazhde të disiplinuar njohurish. Do të jem i palëkundur për këtë vendim, bile edhe atëherë kur të jem i dobët dhe i tunduar për të aplikuar një përgjegjësi të tillë, ose t'ja hedh fajin pengesave që e bëjnë detyrën të vështirë.

Unë do të jem këmbëngulës në vendimin tim për të ngjallur respekt për një jetë plot studime dhe respekt për të gjithë të tjerët. Për t'i kryer me besnikëri këto detyra profesionale, unë premtoj të punoj gjithmonë për një kuptim më të mirë të përmbajtjes sime, të praktikës sime udhëzuese e të studentëve që i nënshtrohen tutelës sime. Unë premtoj të kërkoj e mbështes strategjitë që nxisin cilësinë në mësimdhënie e në të mësuar dhe t'i organizoj të gjithë të angazhohen në arsimim dhe t'i jap mundësinë të arrijnë përsosmëri. Premtoj të matem me cilësitë që unë dua të edukoj dhe të mësoj, e të nderoj përgjithmonë një mënyrë demokratike të jetës, që s'mund të ekzistoj pa mendje të lira, të disiplinuar e të kulturuar. Unë e di që me kohë përpjekjet e mia do të ofendojnë privilegjin e statusin, që do të kundërshtohen nga paragjykimet e mbrojtës të pabarazisë dhe që unë do të përballoj argumenta që kërkojnë të dekurajojnë përpjekjet e mia dhe të dobësojnë shpresat e mia. Por unë do të mbetem besnik ndaj besimit që këto përpjekje dhe ndjekje e këtyre qëllimeve do të më bëjnë të vlefshëm për një popull të lirë. Përpara këtij tubimi, unë e lidh veten time me këtë betim.

³ Sadker,M&D, *Mësuesit, Shkollat dhe Shoqëria*, Tiranë, 1995, f.16

² Po aty, f.63



Referime bibliografike

Kraja, M, *Pedagogjia e Përgjithshme*, Tiranë, 2009

Kraja, M, *Pedagogji e Zbatuar*, Tiranë, 2008

Kraja, M, *Mësuesi, Pedagogu, Personaliteti, Etika e Tyre*, Tiranë, 2012

Sadker, M & D, *Mësuesit, Shkollat dhe Shoqëria*, Tiranë, 1995

Musai, B, *Psikologji Edukimi*, Tiranë, 1999

QTKA, *Mësimdhënia me në qëndër nxënësin*, Tiranë, 2005

Musai, B, *Metodologji e mësimdhënies*, 2003

Garo, S, *Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies*, Tetor, 2011

Bozgo, I, *Etika e Mësuesit*, Gjirokastër, 2007

Taraj, P & A, *Modele të mësimdhënies*, Vlorë, 2011

Gjini, R, *Zhvillimi i mendimit kritik në histori*, Tiranë

Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Aspekte të një komunikimi të ri në shkollë*, Tiranë, 1997

Gjipali, A, *Difaktika e Matematikës*, Vlorë, 2006

Revista Mësuesi, Nr. 3,2010